

GJYKATA E APELIT
PAKR 216/15
9 dhjetor 2015

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dariusz Sielicki, kryetar dhe gjyqtar raportues i kolegjit, gjyqtares së EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova dhe gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi, si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Adam Viplak, zyrtar ligjor i EULEX-it dhe nga këshilltari ligjor i EULEX-it Adnan Isufi, në cilësinë e procesmbajtësve, në lëndën penale kundër të pandehurve:

N.V., e arrestuar më 12 nëntor 2012 dhe në paraburgim nga data 14 nëntor 2012,

F.B., në arrest shtëpiak nga data 14 nëntor 2012, ndërsa i burgosur pas marrjes së aktgjykimit të datës 18 dhjetor 2014.

B.B., në arrest shtëpiak nga data 14 nëntor 2012 ndërsa i burgosur pas marrjes së aktgjykimit të datës 18 dhjetor 2014.

E.D., ndërsa i burgosur pas marrjes së aktgjykimit të datës 18 dhjetor 2014.

I.F.,

N.Th., në paraburgim nga data 18 dhjetor 2014 deri më 25 dhjetor 2014.

J.B.,

S.Sh.

Të dënuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës si në vazhdim: **N.V.** dhe **F.B.** për kryerjen e veprave penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (3) të Kodit Penal të Kosovës (KPK 2003), lidhur me veprat penale të pastrimit të parave sipas nenit 32, par. 2, nënpar. 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit

2010, lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe N.V. e dënuar gjithashtu për mashtrim, sipas nenit 335 (2) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe nenit 261 (1) dhe (2) të KPK-së; **B.B.**, **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.** për veprën penale të krimit të organizuar sipas nenit 274 (1) të KPK-së, lidhur me veprën penale të pastrimit të parave sipas nenit 32, par. 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të vitit 2010, lidhur me nenin 23 të KPK-së; **J.B.** dhe **S.Sh.** për veprën penale të pranimit të mallrave të vjedhura, sipas nenit 3 (2) të KPRK-së dhe nenit 272 (1) të KPK-së,

Duke i shqyrtuar ankesat e mbrojtësit Ali Beka për të pandehurën **N.V.** më 1 prill 2015, mbrojtësit Mexhid Sylja për të pandehurin **F.B.** më 1 prill 2015, mbrojtësit Bajram Tmava për të pandehurin **B.B.** më 1 prill 2015, mbrojtësve Skender Musa dhe Nikë Shala për të pandehurin **E.D.** më 2 prill 2015, mbrojtëses Sabrie Krasniqi për të pandehurin **I.F.** më 2 prill 2015, mbrojtësit Vedali Zejnullahu për të pandehurin **N.Th.** më 4 prill 2015, mbrojtësit Naim Kraqini për të pandehurin **J.B.** më 27 mars 2015, mbrojtëses Zymrete Zeka për të pandehurin **S.Sh.** më 31 mars 2015 si dhe personalisht të të pandehurit **S.Sh.** më 31 mars 2015, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Pkr nr. 1046/12, të datës 18 dhjetor 2014,

Pas marrjes parasysh të përgjigjeve të prokurorit publik;

Pas shqyrtimit të mendimit të Prokurorisë së Apelit të Republikës së Kosovës, të datës 3 tetor 2015,

Pas seancave publike të mbajtura në Gjykatën e Apelit më 26 tetor 2015 dhe më 30 nëntor 2015,

Pas këshillimit më 3 dhjetor 2015 dhe më 9 dhjetor 2015 si dhe votimit më 9 dhjetor 2015;

Në pajtim me nenet 389, 394, 398, dhe 403 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tej në tekst "KPP"), e merr këtë:

Aktgjykim

- I.** Ankesa e mbrojtësit për të pandehurën **N.V.**, ankesën për të pandehurin **F.B.**, ankesën për të pandehurin

B.B., ankesën për të pandehurin **E.D.**, ankesën për të pandehurin **I.F.**, ankesën për të pandehurin **N.Th.**, pranohen pjesërisht. Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Themelore të Prishtinës Pkr. Nr 1046/12 i datës 18 dhjetor 2014, ndryshohet sa i përket cilësimit juridik dhe vendimit mbi dënimin si në vijim:

1. Lidhur me të pandehurën **N.V.**:

1.1. **N.V.**, prej 13 dhjetorit 2011 deri në nëntor 2012, në Prishtinë, me qëllim të përfitimit të paligjshëm për veten e saj dhe për persona të tjerë ka mashtruar Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Österreichische Staatsdruckerei ma anë të përfaqësimit të rrejshëm për transferimin e shumës prej 1, 420,255.13 Eurosh në xhirollogarinë e saj bankare, të përvetësuar në mënyrë të paligjshme.

- **N.V.**, në këtë mënyrë ka kryer veprën penale:

- Mashtrim në bazë të nenit 335 të KPRK-së, dhe për këtë vepër ajo dënohet me 4 (katër) vjet burgim;

1.2. **N.V.**, pasi ka marrë shumën prej 1, 420,255.13 Eurosh me anë të mashtrimit dhe pasi e ka përzier atë shumë me paratë e saja të fituara ligjshëm, i ka tërhequr ato, i ka shpenzuar dhe ka transferuar shuma të ndryshme parash te persona të tjerë, në shumë paushallë prej 669,000 Eurosh me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura;

- **N.V.**, në këtë mënyrë ka kryer veprën penale:

Pastrim i parave i kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 32, par. 2, nënpar. 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2010 si dhe nenit 31 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale ajo dënohet me 6 (gjashtë) vjet burgim dhe me gjobë prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro.

1.3 Sipas nenit 80, par. 1 të KPRK-së, për të dyja veprat penale **N.V.**, dënohet me dënim unik prej 8 (tetë) vjet burgim dhe me gjobë prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro.

2. Lidhur me të pandehurin **F.B.**:

2.1. **F.B.**: në bashkëkryerje me **N.V.**, prej 14 dhjetorit 2011 deri në nëntor 2012, në Prishtinë, ka transferuar shuma të ndryshme parash personave dhe kompanive; më saktësisht ka transferuar shumën prej 669,000 Eurosh te Pirro SHPK, Qeramika LB, Kosovë SHPK, Ron Ing SHPK dhe Construction Beton SHPK, shumën prej 342,825 Eurosh për t'i përmbushur borxhet dhe shpenzimet e veta personale dhe të **N.V.**, duke përfshirë blerjen e apartamentit për 77,000 Euro për **N.V.** dhe 39,000 Euro në Kompaninë e **F.B.** "Fimex", si dhe 20,000 Euro të tjera në Kompaninë e Betim Blakajt "Fib Oil", me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura;

- **F.B.**, në këtë mënyrë ka kryer vepër penale Pastrim i parave i kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 32, par. 2, nën par. 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2010 si dhe nenit 31 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale ai dënohet me 6 (gjashtë) vjet burgim dhe me gjobë prej 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro.

3. Lidhur me të pandehurit **B.B.**, **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.**:

3.1. Prej 14 dhjetorit 2011 deri në nëntor 2012, në Prishtinë, **B.B.**, si pronar i Kompanisë Fib Oil, **E.D.**, si person i autorizuar në Kompaninë Pirro SHPK dhe aksionar në Qeramika LB Kosovë SHPK, **I.F.** si aksionar i Kompanisë Ron ING dhe **N.Th.**, si *de facto* person kontrollues i Kompanisë Construction Beton SHPK, në bashkëkryerje me **N.V.** dhe **F.B.**, të pandehurit **B.B.**, **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.** kanë pranuar shuma parash (**B.B.** shumën paushallë prej 20,000

Eurosh; **E.D.**, shumë paushallë prej 400,000 Eurosh; **I.F.** shumë paushallë prej 200,000 Eurosh; dhe **N.Th.**, shumë paushallë prej 69,000 Eurosh) të cilat ishin të ardhura të krimit me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura;

- Në këtë mënyrë, **B.B.**, **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.**, secili prej tyre kanë kryer veprën penale:

Pastrim i parave i kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 32, paragrafit 2, nën paragrafit 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2010 si dhe nenit 31 të KPRK-së, dhe për këtë veprë penale ata dënohen si në vijim:

- 3.2. **B.B.** me 1 (një) vit burgim dhe me gjobë prej 3,000 (tre mijë) euro.
- 3.3. **E.D.** me 5 (pesë) vjet burgim dhe me gjobë prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.
- 3.4. **I.F.** me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë prej 8,000 (tetë mijë) euro.
- 3.5. **N.Th.** me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë prej 5,000 (pesë mijë) euro.

II. Ankesat e paraqitura për **J.B. dhe S.Sh.**, pranohen. Në pajtim me nenin 364, paragrafin 1.1 dhe 1.2 si dhe me nenin 4, paragrafin 1 të KPP-së, të pandehurit Jakup Blakqori dhe Sefedin Shala shfajësohen për veprën penale të cilësuar si pranim i mallrave të vjedhura sipas nenit 272, par. (1) dhe (2) të KPK-së, për shkak se vepra për të cilën ata janë dënuar nuk i përmbush karakteristikat e kësaj vepre.

III. Lidhur me kompensimin e palës së dëmtuar;

Në pajtim me nenin 463 të KPP-së, vendimi për kompensimin e palës së dëmtuar ndryshohet në tërësi dhe pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pronësore për kompensimin e të gjitha dëmeve si pasojë e krimeve të

cilat iu atribuohen të akuzuarve, mund ta parashtrojë në procedurë civile.

IV. Në pajtim me nenin 365, par 1.5 të KPP-së, koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak do të llogaritet: për të pandehurën **N.V.** nga data 12 nëntor 2014, për të pandehurin **F.B.** nga data 12 nëntor 2014, për të pandehurin **B.B.** nga data 12 nëntor 2014, për të pandehurin **E.D.** nga data 18 dhjetor 2014, për të pandehurin **I.F.** nga data 18 dhjetor 2014 deri më 25 dhjetor 2014, ndërsa për të pandehurin **N.Th.** nga data 18 dhjetor 2014 deri më 25 dhjetor 2014.

V. Pjesa tjetër e aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës mbetet në fuqi.

VI. Sa i përket urdhrit për konfiskimin:

1.1. Urdhri për konfiskim i identifikuar me numrin PKR nr. 1046/14, i lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës, i datës 18 dhjetor 2014, konfirmohet në pikat I.a dhe I.c. Rrjedhimisht, konfiskohen në mënyrë të përhershme këto asete: banesa nr. A/5, në katin përdhes, me sipërfaqe 100.08 m² si dhe garazhi (në nivelin minus 3) në rrugën Tirana, nr. 42 në Prishtinë, Kosovë, me vlerë prej 77,000 eurosh, i blerë nga **N.V.**; si dhe banesa B/1, në katin e tetë, me sipërfaqe prej 66.2 m², në objektin A1, banesa 2B+p+8+NK, blloku A11, zona Mati 1, Prishtinë, Kosovë, me vlerë të përafërt prej 45,000 eurosh, e blerë nga **E.D.**.

2. Urdhri i sipërpërmendur ndryshohet në pikën I.b ashtu që refuzohet kërkesa për konfiskimin e aseteve të emëruara në pikën I.b, për shkak se asetet në fjalë nuk janë identifikuar në mënyrë të mjaftueshme.

VII. Të gjitha pjesët tjera të urdhrit të përmendur të Gjykatës Themelore të Prishtinës vazhdojnë të mbeten në fuqi.

VIII. Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP-së, Gjykata e Apelit ka vendosur se nuk ka pasur shpenzime gjatë procedurës penale në Gjykatën e Apelit.

ARSYETIM

I. Procedura e gjertanishme

1. Pas përfundimit të hetimeve, më datën 7 nëntor 2013, prokurori i Gjykatës Themelore të Prishtinës e ka ngritur aktakuzën, e cila pastaj është ndryshuar më 3 shkurt 2014 dhe më 27 mars 2014.
2. Gjykimi ka nisur më 22 maj 2014 dhe ka përfunduar më 18 dhjetor 2014. Janë mbajtur gjithsej 27 seanca gjyqësore.
3. Më 18 dhjetor 2014, Gjykata Themelore e Prishtinës e ka sjellë aktgjykimin në këtë lëndë penale. Të pandehurit **N.V.** dhe **F.B.** janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprave penale të krimit të organizuar në pajtim me nenin 274 (3) të KPK-së, lidhur me veprën penale të pastrimit të parave, në pajtim me nenin 32, par. 2, nënpar. 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të vitit 2010, lidhur me nenin 23 të KPK-së. E pandehura **N.V.** po ashtu është shpallur fajtoare edhe për veprën penale të mashtrimit, në pajtim me nenin 335 (2) të KPRK-së dhe nenin 261 (1) dhe (2) të KPK-së. Të pandehurit **B.B.**, **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.** janë shpallur fajtorë për veprën penale të krimit të organizuar, në pajtim me nenin 274 (1) të KPK-së lidhur me veprën penale të pastrimit të parave, në pajtim me nenin 32, par. 2, nënpar. 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në kuptim të nenit 23 të KPK-së. Të pandehurit **J.B.** dhe **S.Sh.** janë shpallur fajtorë për veprën penale pranim i mallrave të vjedhura, në pajtim me nenin 3 (2) të KPRK-së dhe me nenin 272 (1) të KPK-së.

4. E pandehura **N.V.** është dënuar me 11 vjet burgim dhe me gjobë prej njëzet e pesë mijë (25,000) eurosh për veprën penale të krimit të organizuar, lidhur me pastrimin e parave, dhe me katër (4) vjet burgim dhe me gjobë prej një mijë (1,000) eurosh për veprën penale të mashtrimit. Në pajtim me nenin 71, e pandehura **N.V.** është dënuar me dënimin unik prej dymbëdhjetë (12) vjet burgim dhe me gjobë prej 25,000 eurosh.
5. I pandehuri **F.B.** është dënuar me 11 vjet burgim dhe me gjobë prej njëzet e pesë mijë (25,000) eurosh për veprën penale të krimit të organizuar, lidhur me pastrimin e parave.
6. Të pandehurit **B.B.**, **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.** janë shpallur fajtorë për krim të organizuar lidhur me pastrimin e parave si pjesë e grupit të organizuar penal dhe për këtë krim janë dënuar si vijon:
- **B.B.** me pesë (5) vjet burgim dhe me gjobë prej 10,000 Eurosh,
 - **E.D.** me tetë (8) vjet burgim dhe me gjobë prej 20,000 Eurosh,
 - **I.F.** me pesë (5) vjet burgim dhe me gjobë prej 8,000 Eurosh,
 - **N.Th.** me katër (4) vjet burgim dhe me gjobë prej 8,000 Eurosh.
7. Të pandehurit **J.B.** dhe **S.Sh.** janë shpallur fajtorë për pranim të mallrave të vjedhura, dhe prandaj janë dënuar si vijon:
- **J.B.** me një (1) vit burgim dhe me gjobë prej 5,000 Eurosh,
 - **S.Sh.** me një (1) vit burgim dhe me gjobë prej 5,000 Eurosh.
8. **N.V.** është liruar për keqpërdorim të besimit.
9. Të gjithë të akuzuarit përveç të pandehurit **B.B.** janë liruar për veprën shmangie nga tatimi, ndërsa **B.B.** nuk është akuzuar fare për këtë krim.

10. Të pandehurit **N.V.** dhe **F.B.** ishin ngarkuar në mënyrë solidare t'ia kompensojnë palës së dëmtuar shumën prej 1,420,255.13 eurosh, përcaktimi i së cilës mund të jetë objekt i procedurave civile, së bashku me këta të akuzuar:

- **B.B.** shumën prej 20,000 Eurosh.
- **E.D.** dhe **J.B.** shumën prej 400,000 Eurosh.
- **I.F.** dhe **S.Sh.** shumën prej 200,000 Eurosh.
- **N.Th.** shumën prej 69,000 Eurosh.

11. Për cilësimin e krimeve të cilat i atribuohen të akuzuarve, gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar Kodin Penal të Kosovës të vitit 2003 pasi që është dukur të jetë më i favorshëm sesa ligji i cili ka hyrë në fuqi pasi ishin kryer krimet në fjalë.

12. Po ashtu është konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës mund të parashtrojë kërkesa pronësore ndaj të gjithë të pandehurve në një procedurë civile apo administrative.

13. Më 18 mars 2015, Gjykata Themelore e Prishtinës, me aktvendimin e sjellë ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të këtyre aseteve:

1. Banesës nr. A/5, në katin përdhes, me sipërfaqe prej 100.08 m² dhe një garazhe (në nivelin minus 3) në rrugën Tirana, nr. 42 në Prishtinë, Kosovë, me vlerë prej 77,000 eurosh, të blerë nga **N.V.**;
2. Të gjitha aseteve të restorantit që gjendet në pjesën perëndimore të stadiumit të qytetit në Prishtinë, Kosovë, me sipërfaqe prej 586 m², me vlerë të përafërt prej 250,000 eurosh, të blerë nga **E.D.**;
3. Banesës B/1, në katin e tetë, me sipërfaqe prej 66.2 m², në objektin A1, banesës 2B+p+8+NK, blloku A11, zona Mati 1, Prishtinë, Kosovë, me vlerë të përafërt prej 45,000 eurosh, të blerë nga **E.D.**.

14. Të gjithë të pandehurit kanë ushtruar ankesa kundër aktgjykimit përmes avokatit mbrojtës. I pandehuri **S.Sh.** po ashtu ka ushtruar ankesë pro se.

15. Mbrojtësit e të pandehurve **N.V.** dhe **E.D.** gjithashtu kanë parashtruar ankesa kundër urdhrin të datës 18 mars 2015, për shkak të aktvendimit të gabueshëm mbi konfiskimin.

II. ANKESAT

16. Avokatët kanë ushtruar ankesa brenda afatit kundër aktgjykimit në fjalë:

- Ali Beka duke e përfaqësuar të pandehurën **N.V.**,
- Mexhid Sylja, duke e përfaqësuar të pandehurin **F.B.**,
- Bajram Tmava duke e përfaqësuar të pandehurin **B.B.**
- Skander Musa dhe Nike Shala, duke e përfaqësuar të pandehurin **E.D.**,
- Sabrie Krasniqi duke e përfaqësuar të pandehurin **I.F.**,
- Vedali Zejnullahu duke e përfaqësuar të pandehurin **N.Th.**,
- Naim Kraçini duke e përfaqësuar të pandehurin **J.B.**
- Zymrete Zeka duke e përfaqësuar të pandehurin **S.Sh.**,

17. I akuzuari **S.Sh.** ka ushtruar ankesë *pro se*.

18. Të gjithë mbrojtësit janë thirrur në të gjitha bazat e ankesës, të cilat përcaktohen me nenin 383, paragrafin 3:

- shkelje esenciale e procedurës penale;
Në përgjithësi të gjithë mbrojtësit kanë pretenduar se dispozitivi i aktgjykimit ka qenë i pakuptueshëm, në kundërthënie me veten dhe me arsyetimin, duke u mbështetur në prova selektive. Disa prej mbrojtësve kanë prezantuar shembuj të këtij pohimi.
- shkelje e ligjit penal;
Të gjithë mbrojtësit kanë theksuar se gjykata nuk ka arritur t'i vërtetojë elementet e domosdoshme të veprës së krimit të organizuar, në veçanti strukturën e grupit kriminal dhe ndarjen e roleve.

- vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- të gjithë mbrojtësit kanë pretenduar se të akuzuarit nuk kanë kryer veprime kriminale.

19. Mbrojtësit po ashtu e kanë kundërshtuar edhe vendimin mbi dënimet.

- Mbrojtësit Skender Musa dhe Nikë Shala kanë kërkuar në mënyrë ekskluzive që të lirohet i pandehuri i tyre, përderisa mbrojtësi Bajram Tmava dhe **S.Sh.** pro se kanë kërkuar vetëm që lënda në fjalë të dërgohet për rigjykim.
- Mbrojtësja Zymrete Zeka ka kërkuar që t'i caktohet një dënim më i butë të pandehurit **S.Sh.** ose që lënda të dërgohet në rigjykim.
- Të gjithë mbrojtësit e tjerë kanë kërkuar që aktgjykimi të ndryshohet dhe që të pandehurit të lirohen nga të gjitha akuzat, ose që aktgjykimi të anulohet dhe lënda të dërgohet në rigjykim.

20. Ankesa e mbrojtësit Ali Beka për të pandehurën **N.V.** i referohet:

A. shkeljes së procedurës penale

Në këtë ankesë pretendohet se:

- A.1) në pjesën hyrëse të aktgjykimit mungon data kur është shkruar aktgjykimi, siç përcaktohet me nenin 370, par. 2 të KPP-së);
- A.2) aktgjykimi është dërguar tre (3) muaj pasi është shpallur (neni 369 par. 1 i KPP-së),
- A.3) ka pasur mungesë të arsytimit për mospranimin e propozimit të mbrojtjes për një ekspertizë të pavarur financiare;
- A.4) ka pasur kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit:

- a) **N.V.** është shpallur fajtores për krimin sipas nenit 274, par. 1, 3 dhe 7, përderisa arsyetimi i referohet vetëm nenit 274, par. 3;
 - b) Gjykata nuk arritur ta vërtetojë nëse **N.V.** në fakt ka qenë e autorizuar nga OeSD apo është prezantuar rrejshëm në emër të tyre;
- A.5) dispozitivi ka qenë i paqartë lidhur me vendimin mbi kërkesën pronësore:
- a) **N.V.** dhe **F.B.** janë obliguar që ta kompensojnë palën e dëmtuar "së bashku dhe ndaras" që do të thotë se pala e dëmtuar do të kompensohej dy herë;
 - b) Përcaktimi i palës së dëmtuar i lihet procedurës civile përderisa kompensimi duhet t'i paguhet palës së dëmtuar brenda afatit të specifikuar kohor;
 - c) Shuma e kompensimit nuk është e definuar qartë në aktgjykim;
- B. Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike;

Mbrojtësi e ka prezantuar versionin e vet të ngjarjeve i cili ndryshon shumë nga të gjeturat e gjykatës. Mospërputhja më e dukshme ka të bëjë me gjetjen se **N.V.** nuk ka qenë e autorizuar që të veprojë në emër të OeSD-së, dhe të gjitha mospërputhjet e tjera vijnë si pasojë e kësaj.

C. Shkelja e ligjit penal

1. Lidhur me cilësimin juridik:

Për shkak se:

- a) Veprimi i **N.V.** është cilësuar gabimisht si krim i organizuar pasi që nuk ishin plotësuar kushtet për ekzistimin e grupit të organizuar.

- b) Nuk ka pasur pastrim të parave sepse origjina e këtyre parave ka qenë e njohur dhe paratë në fjalë nuk kanë ardhur nga ndonjë burim i kundërligjshëm.
- c. Nuk ka është kryer vepra e mashtrimit pasi që **N.V.** nuk e ka mashtruar as kompaninë Österreichische Staatsrueckerei GmbH (më tej në tekst si OeSD) as Ministrinë e Punëve të Brendshme (më tej në tekst MPB), pasi që të gjitha veprimet e saj kanë qenë të organizuara ashtu si duhet.

2. Lidhur me caktimin e dënimit për veprën e mashtrimit, gjykata i ka shqiptuar **N.V.** edhe dënim me burgim dhe me gjobë, përderisa me KPK përcaktohet vetëm dënimi me burgim për këtë krim.

21. Ankesa e mbrojtësit Mexhid Syla në emër të të pandehurit **F.B..**

Ankesa i referohet:

A. Shkeljes esenciale të procedurës penale sepse:

- a) Në aktgjykim nuk është dhënë data e përpilimit të aktgjykimit;
- b) Nuk ishte respektuar raporti kohor i përcaktuar për dërgimin e aktgjykimit palëve përkatëse;
- d) Ishte refuzuar propozimi për ekspertizën financiare ndërsa nuk ishin prezantuar arsyet;
- e) Ka kundërthënie në aktgjykim sepse në dispozitiv thuhet se disa shuma të parave **F.B.** i kishte transferuar vetë, ndërsa në arsyetim thuhet se ishte marrë vesh me persona të tjerë për këto transferime;
- f) nuk ishte vërtetuar se kujt i ishin transferuar shumat e caktuara të parave.

Lidhur me kërkesën pronësore juridike:

Vendimi mbi kërkesën pronësore është i dykuptimtë për shkak se:

a) **N.V.** dhe **F.B.** obligoheshin ta kompensojnë palën e dëmtuar "në mënyrë të përbashkët dhe ndaras" gjë e cila e bën të paqartë se nga sa duhej të paguante secili prej tyre.

b) Përcaktimi i palës së dëmtuar është lënë të bëhet gjatë procedurës civile.

c) në aktgjykim nuk është justifikuar shuma e kompensimit;

B. Vërtetimi i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Mbrojtësi në përgjithësi pretendon se provat në këtë lëndë nuk i mbështesin të gjeturat e gjykatës. Vërtetimi i fakteve është bërë sipas aktakuzës dhe pas fjalës përfundimtare të prokurorit.

3. Mbrojtësi e thekson faktin se aktgjykimi është marrë duke i shkelur në mënyrë esenciale dispozitat e procedurës penale, dhe se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, ndërsa si rezultat ka pasur shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit duke e gjykuar dhe duke e dënuar të pandehurin **B.** për veprën penale e cila nuk është provuar se është kryer.

C. Shkelja e ligjit penal

1. Lidhur me krimin e organizuar:

Veprimet të cilat i atribuohen të pandehurit **F.B.** nuk përbënin krim të organizuar pasi që ato nuk përmbanin elementet e këtij krimi, pasi që i njëjti nuk kishte vepruar në një grup të organizuar dhe të strukturuar. Nuk kishte role që iu atribuoheshin anëtarëve të grupit dhe nuk kishte prova që **F.B.** e kishte organizuar apo e kishte mbikëqyrë grupin e organizuar.

2. Lidhur me pastrimin e parave

Veprimet të cilat i atribuohen të pandehurit **F.B.** nuk përbëjnë vepër të pastrimit të parave, sepse:

- a) përcaktimi i shumës së parave të transferuara nga **F.B.** gjatë kryerjes së këtij krimi është i dykuptimtë pasi që gjykata në arsyetim e ka përdorur shprehjen "përafërsisht";
- b) në aktgjykim është përdorur shprehja "para të vjedhura", edhe pse akuza për pranimin e mallrave të vjedhura që lidhet me akuzën e pastrimit të parave është hedhur poshtë pas shqyrtimit fillestar;
- c) paratë të cilat **F.B.** gjoja i paska pastruar nuk rrjedhin nga krimi në fjalë pasi që ato janë siguruar si pagesë për obligimet kontraktuale.

3. lidhur me vendimin mbi sanksionet penale, caktimi i dënimit nuk ka qenë i ligjshëm sepse:

- **F.B.** nuk ka kryer asnjë krim,
- Gjykata i ka konsideruar elementet e krimit si rrethanë rënduese,
- Gjykata nuk i ka vlerësuar drejt rrethanat lehtësuese.

22. Ankesa e mbrojtësit Bajram Tmava për të pandehurin **B.** **(I) B.**

Mbrojtësi pretendon se:

- a) Ka pasur kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit. Megjithatë, mbrojtësi në fjalë nuk e ka treguar këtë me asnjë shembull specifik;
- b) Të gjeturat e gjykatës nuk janë mbështetur me prova;
- c) Të gjitha të gjeturat e gjykatës kanë qenë të gabueshme, në veçanti supozimi se **B.B.** e ka ditur origjinën e parave të pranuar nga **N.V.**, gjë e cila nuk mbështetet me prova;

- d) Ka pasur shkelje të ligjit penal sepse **B.B.** nuk ka qenë fare i lidhur me të akuzuarit e tjerë të dënuar për të njëjtin krim siç janë; **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.**, dhe se i njëjti nuk ka qenë pjesë e asnjë grupi në të cilin ishin **N.V.** dhe **F.B.**. Për këtë arsye, veprimet e **B.B.** nuk përputhen me karakteristikat e krimit të grupit të organizuar;
- e) Vendimi mbi sanksionet penale ka qenë i gabuar sepse gjykata i ka konstatuar vetëm tri (3) rrethana lehtësuese: gjendjen familjare, i pandehuri është një student i ri dhe përfshirja e tij në këtë skemë kriminale ka qenë në masë të vogël. Asnjë prej rrethanave rënduese nuk kishte të bënte në mënyrë specifike me të pandehurin në fjalë.

23. Ankesa e mbrojtësve Skender Musa dhe Nikë Shala për të pandehurin **E.D.**

Mbrojtësit, në përgjithësi, pohojnë se aktgjykimi është i pakuptueshëm dhe kundërthënës. Arsyetimi nuk tregon cilat janë provat në të cilat mbështeten të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk e ka vërtetuar asnjë fakt me të cilin do të provonte veprimin kriminal të të akuzuarit. Në veçanti, gjykata nuk e ka vërtetuar asnjë element esencial të grupit të pohuar të organizuar të cilit i ka takuar i pandehuri në fjalë. Transferimi i parave të përmendura në përshkrimin e krimit, i cili i atribuohet **E.D.**-t ka qenë transferim legjitim.

24. Ankesa e mbrojtëses Sabrie Krasniqi për të pandehurin **I.F.**

Mbrojtësja në përgjithësi i ka kontestuar të gjeturat e gjykatës dhe cilësimin juridik të krimeve të cilat i atribuohen të pandehurit.

- a) Ajo thekson se disa prej bisedave telefonike në mes të **F.B.** dhe **N.V.**, të cilat i janë prezantuar gjykatës si provë nuk i janë referuar të pandehurit **I.F.** por një personi tjetër.

b) Ajo pohon se vërtetimi i fakteve është bërë në mënyrë të gabueshme sepse transferimi i parave që përmendet në përshkrimin e krimit për të cilin është dënuar **I.F.** ka qenë transferim legjitim. **I.F.** nuk ka qenë në dijeni rreth origjinës së kundërligjshme të parave të cilat i ishin transferuar atij. Vërtetimi i fakteve që lidhet me veprimet e të pandehurës **N.V.** po ashtu ka qenë i gabuar.

c) Për më tepër, ajo pohon se gjykata nuk i ka vërtetuar elementet e nevojshme kriminale të veprës së krimit të organizuar.

d)

e) Dënimi ka qenë i gabuar për shkak se **I.F.** duhet të lirohet. Megjithatë, ajo e ka theksuar se i pandehuri ishte dënuar me pesë (5) vjet burgim përdërisa **N.Th.** ishte dënuar për të njëjtën vepër me katër (4) vjet burgim.

25. Ankesa e mbrojtësit Sevdali Zejnullahu për të pandehurin **N.Th.**

Mbrojtësi pohon se gjykata i ka vlerësuar provat duke paragjykuar kundër të pandehurit dhe duke i injoruar provat e prezantuara nga mbrojtja.

Lidhur me cilësimin juridik, mbrojtësi pretendon se elementi i "krimit të rëndë" që lidhet me përkufizimin e krimit të organizuar sipas nenit 274 të KPK-së ka të bëjë me krimin e dënueshëm së paku me katër vjet burgim. Krimi i pastrimit të parave sipas nenit 32, par. 2, nën par. 2.1 të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, i cili ishte aplikuar nga gjykata si vepër e synuar e krimit të organizuar, nuk e përmbush kriterin në fjalë. Gjukata ka konstatuar gabimisht se krim i rëndë do të thotë krimi për të cilin mund të shqiptohet dënimi më i lartë sesa katër vjet,

edhe në qoftë se dënimi minimal i përcaktuar me ligj është më i ulët sesa ky.

Sa i përket sanksionit penal, mbrojtësi pretendon se duhet të lirohet **N.Th.** Megjithatë, gjykata i ka marrë si rrethana rënduese faktet se **N.Th.** nuk ka mundur të mbahet përgjegjës për vonesën në prodhimin e pasaportave dhe dokumenteve të tjera identifikuese. Gjukata e ka marrë parasysh si faktor lehtësues faktin se **N.Th.** ka qenë më pak i përfshirë në skemën kriminale në fjalë. Mbrojtësi e ka theksuar se shprehja "në masë më të vogël" nuk ka qenë e qartë.

26. Ankesa e mbrojtësi Naim Krasniqi për **J.B.-n.**

Mbrojtësi pretendon se aktgjykimi nuk është shkruar si duhet dhe se nuk i përmban të gjitha elementet e domosdoshme të përcaktuara me ligj.

Nuk është shpjeguar pse **J.B.** e kishte ditur se kishte pranuar para të vjedhura, përderisa kishte persona të tjerë të cilët gjithashtu kishin pranuar transfere të tilla nga **N.V.**, por që nuk ishin akuzuar fare.

Propozimi për ekspertizën e pavarur financiare është refuzuar pa dhënë fare arsye.

Mbrojtësi pretendon se J.B. kishte një aktivitet legjitim afarist.

27. Ankesa e mbrojtëses Zymrete Zeka për të pandehurin **S.Sh..**

Mbrojtësja, në përgjithësi, pretendon se nuk kishte prova se **S.Sh** e dinte origjinën e parave të pranuar, prandaj duhej të lirohej nga akuza për pranim të mallrave të vjedhura.

Sa i përket dënimit, mbrojtësja ka prezantuar faktorë lehtësues të cilët gjykata nuk ka arritur t'i vërejë:

- Faktin se i akuzuari është i ri dhe ka dy fëmijë dhe se kundër tij nuk është duke u zhvilluar ndonjë procedurë tjetër ndaj tij për krime të ngjashme.

28. Ankesa e **S.Sh** pro se

I akuzuari pohon se aktgjykimi nuk është shkruar qartë. Ai e thekson se nuk ka pasur qëllim që të pranojë para të vjedhura sepse nuk e ka ditur origjinën e tyre dhe se gjykata nuk ka arritur t'i mbështesë të gjeturat e veta lidhur me këtë çështje.

I akuzuari e ka ngritur çështjen se gjykata nuk i ka marrë parasysh disa prej rrethanave lehtësuese: bashkëpunimin e tij me gjykatën dhe gjendjen e tij familjare.

III. PËRGJIGJET NË ANKESAT

29. Prokurori i PSRK-së i EULEX-it është përgjigjur se ankesat nuk arrijnë të mbështesin asnjë gabim në aktgjykimin e Gjykatës Themelore, i cili do ta bënte të domosdoshme anulimin apo ndryshimin e aktgjykimit.

30. Prokurori i apelit në propozimin e tij të datës 2 qershor 2015 është pajtuar me qëndrimin e prokurorit të PSRK-së. Prokurori i apelit pretendon se gabimet e vogla procedurale të cilat janë theksuar nga mbrojtësit, të konsideruara së bashku, nuk përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat paragjykohet në mënyrë të konsiderueshme e drejta e të akuzuarit në gjykim të drejtë.

IV. PROCEDURA NË GJYKATËN E APELIT

31. Pas vendimit të kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 16 shtator 2015, Gjykata e Apelit në Prishtinë në përbërjen e gjyqtarit të EULEX-it Dariusz Sielicki, kryetar dhe gjyqtar raportues dhe gjyqtarës së EULEX-it Anna Adamska-Gallant dhe gjyqtarit të Gjykatës së

Apelit Xhevdet Abazi, si anëtarë të kolegjit, e ka caktuar seancën për datën 26 tetor 2015.

32. Më 26 tetor 2015, gjatë seancës në fjalë, mbrojtësit e kanë kundërshtuar përbërjen e kolegjit në fjalë. Mbrojtësit kanë kërkuar përjashtimin e anëtares së kolegjit, përkatësisht gjyqtares së EULEX-it Anna Adamska-Gallant, për shkak se ajo kishte qenë e përfshirë edhe më herët në këtë çështje penale. Mbrojtësit më tutje kishin pretenduar se kolegji duhej të përbëhej me shumicë të gjyqtarëve vendorë dhe të kryesohej nga gjyqtari vendor pasi që nuk ka ndonjë vendim të marrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me të cilin do të ndryshohej përbërja e kolegjit me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.
33. Më 26 nëntor 2015, gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant, në bazë të nenit 39, par. 2 të KPP-së i ka raportuar kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it se e njëjta kishte marrë pjesë në procedurën e mëhershme të çështjes në fjalë.
34. Më 26 nëntor 2015, rrjedhimisht kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it kishte vendosur ta zëvendësonte gjyqtaren e EULEX-it Anna Adamska-Gallant me gjyqtaren e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova.
35. Më 30 nëntor 2015, Gjykata e Apelit në Prishtinë, në përbërjen e gjyqtarit të EULEX-it Dariusz Sielicki, kryetar dhe gjyqtar raportues, gjyqtares së EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova dhe gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi, si anëtarë të kolegjit, e kanë caktuar seancën në lëndën penale në fjalë.
36. Në seancën para Gjykatës së Apelit të mbajtur më 30 nëntor 2015, nuk ka pasur asnjë kërkesë nga palët për përjashtimin e anëtarëve të kolegjit në procedurë.

V. TË GJETURAT E GJYKATËS SË APELIT

37. Në mënyrë që gjykata të jetë në gjendje për t'i shqyrtuar ankesat e mbrojtësve, është e domosdoshme që së pari ta shqyrtojë nëse janë plotësuar apo jo kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në KPP.
38. Gjykata e Apelit konstaton si në vijim:
- a. Të gjitha ankesat janë të pranueshme. Ato janë parashtruar në gjykatën kompetente në pajtim me nenin 388, par. 1 dhe brenda afatit të përcaktuar me neni 380, par. 1 të KPP-së.
 - b. Gjykata e Apelit ka vendosur në seancë të kolegjit në pajtim me nenin 390 të KPP-së. Nuk ka pasur nevojë për seancë dëgjimore në pajtim me nenin 391 të KPP-së.
39. Gjatë shqyrtimit nëse ka pasur shkelje të ligjit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha provat e prezantuara, qofshin ato të mbrojtjes, të të pandehurve apo të burimeve tjera, apo të cilat i ka siguruar *proprio motu*.
40. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kolegji gjen se aktgjykimi i apeluar nuk kërkon një intervenim *ex officio* në bazë të nenin 394 të KPP-së. Për këtë arsye, kolegji do të kufizohet vetëm në ato shkelje ligjore të cilat parashtruesit i pretendojnë në ankesat e tyre.
41. Sa i takon përjashtimit të gjyqtares së EULEX-it Anna Adamska-Gallant, e njëjta është zëvendësuar nga gjyqtarja tjetër e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova.
42. Për sa i takon përbërjes së kolegjit me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it, kolegji konstaton se juridiksioni i gjyqtarëve të EULEX-it dhe përbërja e kolegjeve në lëndët në të cilat gjyqtarët e EULEX-it e ushtrojnë juridiksionin e tyre rregullohen me Ligjin mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve lidhur me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës (Ligji nr. 04/L-273), (më tutje në tekst si *Ligji Omnibus*) dhe me marrëveshjen në mes të shefit të EULEX-it

në Kosovë dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët kosovarë në gjykatat vendore, marrëveshje e cila është arritur më 18 qershor 2014 (në tej në tekst: Marrëveshja).

43. Neni 1. A. i *Ligjit Omnibus* e përcakton juridiksionin e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët në vazhdim e sipër. Lëndët në vazhdim, sipas këtij ligji, janë:

1. *Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin.*

2. *Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.*

44. Sa i përket përbërjes së kolegjit, neni 3.2 përcakton si në vijim:

3.2. *Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve të vendorë dhe do të kryesohen nga një gjyqtar vendor. Pas kërkesës së arsyetuar të autoritetit kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të vendosë që kolegji të përbëhet me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.*

45. Kështu, neni 1. A. i *Ligjit Omnibus* e përcakton juridiksionin e gjyqtarëve të EULEX-it në dy lloje të rasteve: rastet për të cila vendimi mbi fillimin e hetimeve tashmë është marrë para datës 15 prill 2014 si dhe rastet të cilat iu janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

46. Përderisa neni 1. A. i *Ligjit Omnibus* ka të bëjë me juridiksionin, neni 3 i të njëjtit ligj i referohet përbërjes së kolegjeve.

47. Ky Kolegj vëren se përderisa neni 1.A e përcakton juridiksionin e gjyqtarëve të EULEX-it për dy lloje të rasteve, neni 3.2 nuk bën një ndarje të tillë. Neni 3.2

vetëm e thekson se kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it i ushtrojnë kompetencat e tyre në procedurën penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve vendorë dhe të kryesuar nga gjyqtari vendor.

48. Sipas pikëpamjes së këtij kolegji, neni 3.2 i *Ligjit Omnibus* mund të zbatohet për rastet sipas nenit 1.A, par. 1, me kusht që hetimet kanë përfunduar me sukses dhe aktakuza është ngritur. Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, në qoftë se vendimi për të filluar hetimet është marrë para datës 15 prill 2014 por hetimet kanë përfunduar dhe aktakuza është ngritur pas hyrjes në fuqi të *Ligjit Omnibus*, atëherë, dispozitat e *Ligjit Omnibus* mund të jenë të zbatueshme sa i përket përbërjes së trupit gjykues.

49. Situata, megjithatë, është ndryshe prej rasteve të përcaktuara me nenin 1.A. par. 2, të cilat tashmë iu janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014, përkatësisht, para hyrjes në fuqi të *Ligjit Omnibus*. Nëse lënda iu është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2015, atëherë atë lëndë do ta vazhdojnë gjyqtarët e EULEX-it. Kjo do të thotë se përbërja e kolegjit do të jetë në përputhje me ligjin që ka qenë në fuqi në kohën kur ajo lëndë iu është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it. Ndryshimet e mëvonshme të ligjit, siç është rasti tani me hyrjen në fuqi të *Ligjit Omnibus*, sipas mendimit të kolegjit, nuk mund të kenë efekt retroaktiv sa i përket përbërjes së kolegjit.

50. Në mënyrë specifike, në rastin në fjalë, hetimet kanë filluar para datës 15 prill 2014. Në fakt, kjo lëndë bile edhe është mbyllur në shkallën e parë nga kolegji i përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe është kryesuar nga gjyqtari i EULEX-it, në përputhje me Ligjin mbi kompetencat.

51. Çështja është, megjithatë, nëse duhet të vazhdohet apo jo me përbërjen e kolegjit në rastet nga neni 1.A, par. 2 dhe në instancat e mjetëve juridike, p.sh. në shkallën e dytë, me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe të kryesuar nga gjyqtari i EULEX-it.

52. Kolegji është i mendimit se, në rastet e përkufizuara në nenin 1.A, par. 2, përbërja e kolegjeve duhet të vazhdojë të ketë shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe të kryesohet nga gjyqtari i EULEX-it, po ashtu edhe në instancat me mjete juridike, nëse nuk vendoset nga kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it për ndryshim të përbërjes së kolegjit ose për dorëzimin e lëndës gjyqësorit vendor.
53. Ky qëndrim po ashtu mbështetet edhe me Marrëveshjen e përmendur më lart (në paragrafin 42).
54. Sipas nenit 3, par. 3.3 të *Ligjit Omnibus* me kërkesën e arsyetuar të organit kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund të vendosë që kolegji të jetë i përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it. Në bazë të pikës 2 të Marrëveshjes, një vendim i tillë tashmë është marrë në përgjithësi për vazhdimin e të gjitha fazave të gjykimit në të gjitha lëndët në vazhdim e sipër të cilat janë shqyrtuar në shkallën e parë nga kolegjet të përbëra me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.
55. Në bazë të nenit 2, par. 2.3 të *Ligjit Omnibus*, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka qenë në mënyrë eksplicite i autorizuar për t'i rregulluar aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët kosovarë që punojnë në gjykatat vendore.
56. Kolegji e vëren se në Marrëveshje, në pikën e saj 2 theksohet se "në të gjitha rastet në vazhdim e sipër, trupat gjykues të përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it do të vazhdojnë me këtë shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it në kolegji në vazhdim të të gjitha fazave të gjykimit dhe në pjesën tjetër të procedurës".
57. Siç është theksuar tashmë në aktgjykimin PML - KZZ Nr. 170/2014, të datës 19 shkurt 2015, me të cilin kolegji pajtohet në tërësi, duke e përsëritur të njëjtën gjë, duke përdorur shprehjet e ndryshme ('për vazhdimin e të gjitha fazave të gjykimit' dhe 'pjesën tjetër të procedurës'), palët në këtë marrëveshje kanë theksuar se

dispozita në fjalë ka të bëjë me të gjitha fazat e procedurës penale. Kjo do të thotë se dispozita nuk është e kufizuar vetëm për shkallën e parë, por po ashtu i mbulon edhe të gjitha fazat tjera me mjete juridike. Siç është treguar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e përmendur më lart, formulimi i pikës 2 të Marrëveshjes në mënyrë të qartë i referohet 'vazhdimit' me përbërjen e njëjtë të kolegjit, kur theksohet se ... 'në të gjitha rastet në vazhdim, trupat gjyquese të përbëra me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it do të vazhdojnë me këtë shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it'. Ky formulim tregon se qëllimi ka qenë ruajtja e gjendjes së mëparshme kur kemi të bëjmë me çështjet që ndërliken me përbërjen e kolegjit.

58.Kolegji konstaton se procedura e vendosjes së një lënde në vazhdim me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it nuk preket nga ndryshimet që janë në fuqi nga data 30 maj 2014.

Pretendimet për shkelje të dispozitave të kodit të procedurës penale:

59.Mbrojtësit pretendojnë se dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë është në kundërshtim me arsyetimin. Në mënyrë specifike, mbrojtësi i të pandehurës **N.V.** pretendon se në dispozitiv, gjykata ka deklaruar se gjoja **N.V.** e paska mashtruar MPB-në dhe OeSD-në duke u prezantuar në mënyrë të rrejshme, përderisa në arsyetim ka theksuar se çështja është nëse MPB-ja është përgjegjëse për transferimin e parave apo OeSD-ja për lëshimin e autorizimit.

60.Në kontekstin e kontestimit të dispozitivit, ngjashëm mbrojtësi i të pandehurit **F.B.** pohon se në dispozitiv, gjykata deklaron se "**F.B.** e ka transferuar shumën prej 669,000 eurosh", përderisa në arsyetim theksohet "me dashje dhe në mënyrë të kundërligjshme ka bërë aranzhime përmes kontakteve me përfaqësuesit e të ashtuquajturave kompani, lidhur me transferimin e shumës prej 669.000.00 eurosh", ose kur në dispozitiv thuhet se "**F.B.** në bashkëkryerje me **N.V.** ka transferuar kundërligjshëm shumën prej 342,825.00 eurosh për t'i larë borxhet dhe shpenzimet personale të veta dhe të **N.V.**," përderisa në

arsyetim thuhet "ka aranzhuar transferimin e përfaqësuesit 342,825.00 eurove të parave të vjedhura tek individë dhe biznese për t'i larë borxhet dhe shpenzimet e tyre personale." Përveç kësaj, mbrojtësi i **F.B.** thekson se dispozitivi nuk e specifikon vlerën e dëmit të pretenduar, as nuk ofron informata se kujt i janë transferuar këto para gjoja të vjedhura.

61. Gjykata e Apelit gjen se, përveç cilësimit të veprave penale, të cilat do të shtjellohen të gjitha kur të diskutohet zbatimi i ligjit penal, asnjë kundërthënie esenciale dhe/apo mospërputhje me rëndësi nuk është gjetur në dispozitivin e aktgjykimit, ose në mes të dispozitivit dhe arsytimit.

62. Gjykata e Apelit konstaton se dispozitivi iu referohet në mënyrë adekuate të gjitha fakteve vendimtare. Ajo çfarë kërkohet nga dispozitivi që të përmbajë janë detajet e mjaftueshme për të mundësuar mbrojtjen e duhur të të akuzuarit. Çfarëdo shtese tjetër e cila është e tepërt përtej këtij qëllimi legjitim duhet patjetër të evitohet, për shkak se do të paraqiste rrezikun e shkaktimit të konfuzionit në vend të sqarimit.

63. Në arsyetim, gjykata e shkallës së parë i ka prezantuar arsyet për secilën pikë individuale të aktgjykimit. Kolegji, prandaj, është i bindur se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të gjithanshme e ka theksuar cilat fakte janë të provuara e cilat jo, si dhe arsyet për një gjë të tillë, dhe në mënyrë specifike e ka treguar se në cilat prova është mbështetur gjykata kur e ka sjellë aktgjykimin.

64. Sipas pikëpamjes së kolegjit, pretendimet e mbrojtësit lidhur me mospërputhjet brenda aktgjykimit të kundërshtuar janë thjesht vetëm një lexim i pjesshëm dhe/ose i izoluar i dispozitivit nga arsyetimi.

65. Dispozitivi dhe arsyetimi duhet patjetër të lexohen në kontekstin e rrethanave të përgjithshme të lëndës dhe jo në mënyrë selektive. Dispozitivi dhe arsyetimi janë,

në fakt, pjesë përbërëse dhe të pandashme të aktgjykimit të cilat duhet të lexohen së bashku.

66. Kolegji gjen se në lëndën në fjalë, dispozitivi i gjykatës së shkallës së parë i plotëson të gjitha parametrat ligjorë të përcaktuar me nenin 370 të KPP-së.
67. Sa i përket datës kur është përpiluar aktgjykimi si kusht i përcaktuar me nenin 369, par. 1 të KPP-së, kolegji e konsideron këtë lëshim teknik. Kjo gjë, megjithatë, paraqet një *Inritus Irritus* të paefektshëm në substancën e lëndës në fjalë. Kolegji konstaton se neni 369, par. 1 i KPP-së vetëm e përmban dispozitën në fjalë (kushtin e afatit kohor brenda të cilit aktgjykimi duhet të përpilohet), por nuk e përcakton ndonjë sanksion nëse dispozita në fjalë nuk respektohet në tërësi.
68. Kolegji konstaton se thjesht mungesa e datës kur është përpiluar aktgjykimi nuk kualifikohet si shkelje esenciale e KPP-së, as nuk përbën shkelje të të drejtave të të pandehurve për gjykim të drejtë. Duke e pasur parasysh natyrën komplekse të lëndës, gjatësinë e vetë aktgjykimit i cili ka më shumë se 200 faqe, i cili po ashtu është dashur të përkthehet në gjuhët përkatëse, kolegji e konsideron pretendimin e avokatit mbrojtës si të kotë.
69. Kolegji vëren se anulimi i aktgjykimit mund të bëhet vetëm në rrethana shumë të jashtëzakonshme. Kjo do të thotë atëherë kur të jenë plotësuar në tërësi kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 402 të KPP-së, dhe/ose kur Gjykata e Apelit nuk mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit në pajtim me nenin 403 të KPP-së.
70. Kolegji konstaton se mungesa e datës dhe mungesa e vendimit për vazhdimin e afatit për përpilimin e aktgjykimit nuk ka pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Pretendimi i vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike

71. Siç është shpjeguar më lart, të gjithë mbrojtësit pretendojnë se ka pasur vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
72. Në mënyrë specifike, mbrojtësi Ali Beka pretendon se, në kundërshtim me atë çfarë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, **N.V.** ka qenë person i autorizuar e po ashtu edhe përfaqësuese e atëhershme e OeSD-së për implementimin e kontratës për prodhimin e pasaportave biometrike nga OeSD-ja për MPB-në. Kjo është vërtetuar, pretendojnë mbrojtësit, me provat materiale dhe me deklaratën e dhënë nga R.G.. **N.V.** nuk e ka pranuar në mënyrë të kundërligjshme shumën prej 1,420,255.13 eurosh, sepse ka qenë e autorizuar nga OeSD-ja për t'i shtypur dhe për t'i nënshkruar faturat e nxjerra në emër të OeSD për pasaportat e dërguara në MPB. Mbrojtësi pretendon se ndryshimi i faturave lidhur me shumën prej 1,420,255.13 eurosh, e cila nuk ishte transferuar në OeSD, ishte shfrytëzuar për pagesën e tarifave doganore, TVSh-së si dhe detyrimeve të tjera ndaj kompanive për shërbimet e ofruara. Për më tepër, mbrojtësi në fjalë parashtron se dy dëshmitarët në dëshminë e të cilëve është mbështetur gjykata, pra dëshmitarët R.G dhe G.W., nuk janë dëshmitarë të besueshëm.
73. Mbrojtësi i B.B. pretendon se nuk ka prova për të treguar se B.B. e ka formuar, e ka organizuar dhe e ka mbikëqyrë grupin e organizuar kriminal, siç është theksuar nga gjykata e shkallës së parë. Mbrojtësi parashtron se gjykata e shkallës së parë nuk e ka lejuar ekspertizën e pavarur financiare, e cila do t'i kishte larguar dilemat lidhur me vlerën e pretenduar të dëmit, pastaj identifikimin e palëve të dëmtuara, etj.
74. Duke iu adresuar pohimit të mbrojtësit, duke i përjashtuar të pandehurit **J.B.** dhe **S.Sh.**, kolegji është i mendimit se gjykata e shkallës së parë i ka

prezantuar drejt faktet të cilat janë vërtetuar ashtu si duhet dhe ka dhënë arsyetimin e qartë dhe bindës.

75. Është vërtetuar se më 26 korrik 2001, MBP-ja e ka transferuar drejtpërdrejt tek OeSD-ja shumën prej 273,552.58 eurosh, përderisa më 9 nëntor 2011, edhe shumën prej 138,370.00 eurosh. Shuma totale e transferuar prej MPB-së drejtpërdrejt në OeSD ka qenë gjithsej 411,922.58 euro.¹ Ky fakt nuk kontestohet as nga avokati mbrojtës.
76. Provat materiale në të cilat është mbështetur gjykata e shkallës së parë provojnë se **N.V.** i ka ndryshuar të dhënat e llogarisë bankare në faturat e OeSD-së, duke ua ndërruar vendin të dhënave të saja bankare me të dhënat e OeSD-së dhe me këtë duke e shfrytëzuar në mënyrë mashtruese autorizimin me të cilin e ka shtyrë MPB-në që t'i paguante faturat në llogarinë e saj².
77. Gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar se në mes të datës 13 dhjetor 2011 dhe 3 gusht 2012, janë bërë gjithsej shtatë transfere nga MPB-ja në llogarinë e kompanisë Consulting EU në bankën NLB në vlerën totale prej 3,3611,283.25 eurosh. Shuma prej 1,941,028.12 eurosh pastaj është transferuar nga llogaria e Consulting EU tek OeSD-ja, duke e lënë bilancin prej 1,420,255.13 eurosh³.
78. Po ashtë është vërtetuar se **N.V.** kishte bërë transfere në kompani të ndryshme. Në fakt, **N.V.** e ka pranuar se iu kishte transferuar gjithsej 669,000 euro kompanive të ndryshme⁴.

¹ Shih aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, PKR. Nr. 1046/13, të datës 18 dhjetor 2014, faqe 107, Versioni në anglisht.

² Shih aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, PKR.nr 1046/13, të datës 18 dhjetor 2014, faqe 107, Versioni në anglisht, lidhur me faturat: 05/12, P/100827-04, 1110076529 si dhe 1110076601.

³ Shih aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, PKR.nr 1046/13, të datës 18 dhjetor 2014, faqe 109, Versioni në anglisht.

⁴ Shih aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, PKR.nr 1046/13, të datës 18 dhjetor 2014, faqe 111, Versioni në anglisht, lidhur me intervistën me të pandehurën N.V., të datës 16 janar 2013, faqet 9 dhe 11.

79. Kolegji konsideron se gjykata e shkallës së parë e ka provuar me të drejtë se **N.V.** nuk kishte pasur autorizim për t'i pranuar paratë të cilat ishin borxh i OeSD-së.
80. Dëshmitarët **R.G.** dhe **G.W.** kanë dëshmuar se me autorizimin e dhënë nga OeSD-ja, e pandehura **N.V.** nuk ishte e autorizuar për t'i pranuar drejtpërdrejt pagesat nga MPB-ja apo për t'i ndryshuar faturat.
81. Kolegji konsideron se deklaratat e dëshmitarëve **R.G.** dhe **G.W.** janë deklarata të besueshme. Është e qartë se MPB-ja i ka bërë dy transfere parash drejtpërdrejt në OeSD. Askush nuk e konteston këtë dhe kjo, në fakt, konfirmohet me provat materiale. Pse atëherë ka qenë e nevojshme që të ndryshohet mënyra e transfereve? Kolegji konstaton se konkluzioni i gjykatës së shkallës së parë ka qenë i drejtë, përkatësisht se e pandehura **N.V.** ka pasur si qëllim që t'i përvetësojë në mënyrë të kundërligjshme paratë të cilat kanë qenë të caktuara për OeSD-në. Për të arritur këtë, **N.V.** e ka mashtruar edhe MPB-në edhe OeSD-në përmes faturave të falsifikuara.
82. Po ashtu është vërtetuar drejt se shuma të konsiderueshme ishin transferuar tek kompani të ndryshme në pronësi të të pandehurve të tjerë.
83. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka ofruar arsye të mjaftueshme, të qarta dhe bindëse me të cilat provohet se shumat e parave ishin përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme dhe më pastaj ishin transferuar në llogari të ndryshme bankare.
84. Lidhur me ekspertizën financiare të ngritur nga mbrojtja, kolegji konstaton se është shumë e rëndësishme të vërehet se transferet e bëra në mes të bankave kryesisht provohen me fatura. Gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar shumat të cilat janë pranuar dhe pastaj janë transferuar. Kolegji, për këtë arsye, i konstaton pretendimet e mbrojtjes jomeritore.

85. Sa i përket identifikimit dhe/ose kompensimit të palëve të dëmtuara, kolegji mjaftohet duke thënë se pala e dëmtuar udhëzohet të parashtrojë kërkesë për kompensim në procedurën civile. Për këtë arsye, varet nga gjykata civile, duke u bazuar në parimin e disponibilitetit të palëve, për ta vërtetuar legjitimitetin pasiv në pajtim me rregullat e procedurës kontestimore. Kolegji kufizohet në vlerësimin e çështjeve kriminale, prandaj nuk mund ta përcaktojë paraprakisht se cilat palë mund të konsiderohen si të prekura nga veprimet kriminale në fjalë.

Pretendimet lidhur me ligjin penal:

86. Mbrojtja pohon se shkelja e ligjit penal vjen si pasojë e vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike.

87. Përderisa Gjkata e Apelit konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejt, me përjashtim të asaj që u përmend më lart lidhur me të pandehurit **J.B. dhe S.Sh.**, në mënyrë të pjesshme pajtohet me mbrojtësit se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në zbatimin e drejtë të dispozitave të ligjit penal.

88. Pas analizës së hollësishme të aktgjykimit të apeluar, të ankesave dhe të propozimeve të prokurorisë, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka cilësuar veprat penale të atribuuar të pandehurve **N.V. F.B., B.B., E.D., I.F.** dhe **N.Th.** si vepër penale e krimit të organizuar sipas nenit 274 (3) të KPK-së.

89. Kolegji vlerëson se nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, siç kërkohet me ligj, se të pandehurit **J.B** dhe **S.Sh.** e kanë kryer veprën penale të pranimit të mallrave të vjedhura sipas veprës penale të pranimit të mallrave të vjedhura nga neni 272, paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së së vitit 2003.

90. Lidhur me krimin e organizuar, neni 274 i KPK-së, përcakton si në vijim:

(1) Kushdo që kryen krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim së paku shtatë vjet.

(2) Kushdo që aktivisht merr pjesë në aktivitete kriminale ose në aktivitete të tjera të një grupi kriminal të organizuar, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do t'i kontribuojë kryerjes së krimeve të rënda nga grupi kriminal i organizuar dënohet me burgim së paku pesë vjet.

(3) Kushdo që organizon, formon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton veprimet e ndonjë grupi kriminal të organizuar dënohet me gjobën deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(4) Kushdo që kryen vepër penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me gjobë deri në 500.000 EUR dhe me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë nëse veprimtaria e grupit të organizuar rezulton me vdekje.

(5) Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin i cili kryen vepër penale nga paragrafi 2 ose 3 i këtij neni nëse personi i tillë, para se grupi të kryejë veprën, e lajmëron policinë apo prokurorin publik në hollësi lidhur me ekzistimin, përbërjen dhe informacionet e grupit të organizuar për t'i mundësuar policisë arrestimin e grupit apo prokurorit publik ndjekjen e atij grupi.

(6) Kushdo që është dënuar me dënime plotësuese nga neni 57 i këtij Kodi për kryerjen e veprës penale nga ky nen dhe i shkel kushtet e atyre dënimeve plotësuese, dënohet me burgim deri në një vit.

(7) Sipas këtij neni,

1) Shprehja "krim i organizuar" do të thotë krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare;

2) Shprehja "grup kriminal i organizuar" do të thotë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare;

3) Shprehja "krim i rëndë" do të thotë vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet dhe

4) Shprehja "grup i strukturuar" do të thotë grup prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e atypëratyshme të ndonjë vepre penale dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

91. Neni 120 i KPRK-së përcakton:

13. Grup kriminal i organizuar - bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore.

14. Bashkim i strukturuar - bashkim i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar.

92. Neni 283 i KPRK-së, lidhur me pjesëmarrjen ose organizimin e grupit kriminal të organizuar, përcakton si më poshtë:

1. Kushdo që me dashje dhe me dijeni goftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.

2. Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet.

3. Kur veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar të parapara në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni rezultojnë në vdekje, kryesi dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.

4. Gjykata mund të zbusë dënimin e anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili, para se grupi kriminal i organizuar të ketë kryer veprën penale, raporton në polici ose prokurori, ekzistimin, formacionin dhe jep informata për grupin kriminal të organizuar në detaje të mjaftueshme për të mundësuar arrestimin apo ndjekjen e grupit të tillë.

5. Për qëllime të këtij neni, "aktivisht merr pjesë" përfshin, por nuk kufizohet në ofrimin e informatave ose mjeteve materiale, rekrutimin e anëtarëve të rinj dhe të gjitha format e financimit të veprimtarive të grupit.

93. Kolegji e vëren se nuk ka ndonjë ndryshim substancial në mes të këtyre dy kodeve lidhur me faktet materiale që i atribuohen veprës që ajo vepër penale të cilësohet si krim i organizuar. Në të dyja këto kode, vepra penale e krimit të organizuar kërkon ekzistimin e

bashkimit të strukturuar, i cili, *inter alia*, formohet përgjatë një periudhe kohore dhe përbëhet nga tre a më shumë persona. Rolet nuk është e domosdoshme të jenë formalisht të definuara apo që struktura të jetë e zhvilluar, megjithatë për të ekzistuar krimi i organizuar bashkimi i tillë nuk guxon të jetë formuar rastësisht.

94. Kolegji konstaton se në rastin në fjalë, aktet të cilat i atribuohen të pandehurve **N.V., F.B., B.B. E.D., I.F.** dhe **N.Th.** nuk i plotësojnë në tërësi elementet ligjore (figurën) e veprës penale të krimit të organizuar në bazë të nenit 274 (3) të KPK-së. Kolegji konstaton se provat mbi të cilat është mbështetur gjykata e shkallës së parë nuk demonstrojnë se ekzistonte një bashkim i strukturuar, i formuar përgjatë një periudhe kohore dhe përbëhet nga tre a më shumë persona me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore. Prandaj kolegji e konsideron si të gabueshëm cilësimin e akteve të cilat i atribuohen të pandehurve **N.V., F.B., B.B. E.D., I.F.** dhe **N.Th.**, lidhur me krimin e organizuar.

95. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt se **N.V.** ka ndryshuar faturat e OeSD-së me anë të mashtrimit në shumë të përgjithshme prej 3,410,343.91 Eurosh duke shtuar kompaninë e saj dhe numrin e xhirollogarisë së kompanisë së saj Consulting EU (CE) në pjesët e poshtme të faturave. **N.V.** qëllimisht ka fshehur nga OeSD-ja faktin se i ka bërë këto ndryshime dhe e ka mashtruar OeSD-në të besojë se MPB-ja nuk kishte paguar transferet e pranuar prej 738,240 Eurosh dhe 64,596 Eurosh nga MPB-ja. Përveç kësaj, kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt se **N.V.** ka transferuar në mënyrë të paligjshme shumën prej 342,825 Eurosh për mbulimin e borxhit dhe shpenzimeve personale të saj dhe të **F.B.-t**, duke përfshirë blerjen e apartamentit për 77,000 Euro për **N.V.** dhe 39,000 Euro në Kompaninë e **F.B.-t** "Fimex", si dhe 20,000 Euro të tjera në Kompaninë e **B.B.-t** "Fib

Oil", me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura, duke realizuar kështu një fitim substancial financiar.

96. Kolegji konstaton se faktet e lartpërmendura materiale të cilat gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar drejt gjatë gjykimit kundër të pandehurës **N.V.**, plotësojnë elementet e veçanta ligjore (figurën) e veprës penale të mashtrimit sipas nenit 335 të KPK-së dhe pastrimi i parave në pajtim me nenin 32, par. 2, nënpar. (2.1) të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, të kryera në bashkëpunim dhe të veprës penale pastrimi i parave në bashkëkryerje me **F.B.-n.**
97. Po ashtu kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt se **F.B.** në bashkëkryerje me **N.V.** ka transferuar shumën prej 669,000 Eurosh te Pirro SHPK, Qeramika LB, Kosova SHPK, Ron Ing SHPK dhe Construction Beton SHPK. Po ashtu kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt se **F.B.** në bashkëkryerje me **N.V.** ka transferuar në mënyrë të paligjshme shumën prej 342,825 Eurosh për t'i përmbushur borxhet dhe shpenzimet e veta personale dhe të **N.V.- t**, duke përfshirë blerjen e apartamentit për 77,000 Eurosh për **N.V.- n** dhe 39,000 Euro në Kompaninë e **F.B.-t** "Fimex", si dhe 20,000 Euro të tjera në Kompaninë e **B.B.-t** "Fib Oil", me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura duke realizuar kështu një fitim substancial financiar.
98. Kolegji konstaton se faktet e lartpërmendura materiale të cilat gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar drejt gjatë gjykimit kundër të pandehurit **F.B.**, plotësojnë elementet e veçanta ligjore (figurën) e veprës penale të pastrimit të parave në pajtim me nenin 32, par. 2, nënpar. (2.1) të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, të kryera në bashkëkryerje me **N.V..**
99. Ndërkaq, sa iu përket të pandehurve **B.B, E.D., I.F.** dhe **N. Th.**, kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së

parë ka vërtetuar drejt shumat e parave që ata i kanë pranuar me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura duke realizuar kështu një fitim substancial financiar për veten e tyre. Në veçanti, është vërtetuar se **B.B.** (vëllai më i ri i të pandehurit **F.B.**) ishte pronari i Fib Oil dhe ka pranuar shumën prej 20,000 Eurosh të transferuar nga xhirollogaria e Consulting EU e udhëhequr nga **N.V.** në xhirollogarinë bankare të Fib Oil. Lidhur me të pandehurin **E.D.**, kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt se ky ishte zyrtarisht personi i autorizuar në kompaninë Pirro SHPK dhe aksionar në Qeramika LB Kosova SHPK. Është vërtetuar se një shumë paushallë që arrin 400,000.00 Euro është transferuar nga xhirollogaria e Consulting EU në xhirollogaritë bankare të kompanive Pirro SHPK dhe Qeramika LB Kosova SHPK, me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura duke realizuar kështu një fitim substancial financiar. Lidhur me të pandehurin **I.F.**, kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt se ky ishte aksionar në kompaninë Ron ING. Është vërtetuar se një shumë paushallë që arrin 200,000.00 Euro është transferuar nga xhirollogaria e Consulting EU në xhirollogarinë bankare të kompanisë Ron ING, me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura duke realizuar kështu një fitim substancial financiar. Kolegji është i bindur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt se **N.Th.** ishte *de facto* personi në kontroll i kompanisë Construction Beton SHPK. Është vërtetuar se një shumë paushallë që arrin 69,000.00 Euro është transferuar nga xhirollogaria e Consulting EU në xhirollogarinë bankare të kompanisë Beton SHPK, me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit dhe pronësinë e parave të vjedhura duke realizuar kështu një fitim substancial financiar.

100. Kolegji konstaton se faktet e lartpërmendura materiale të cilat gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar drejt kundër të pandehurve **B.B.**, **E.D.**, **I.F.** dhe **N.Th.**, plotësojnë elementet e veçanta ligjore (figurën) e veprës penale të pastrimit të parave në pajtim me nenin

32, par. 2, nën par. (2.1) të Ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, të kryera në bashkëkryerje me **N.V.**

101. Kur është fjala për **J.B.-n dhe S.Sh-n**, kolegji gjen se nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, siç kërkohet me ligj, se ata kanë kryer veprën penale të pranimit të mallrave të vjedhura në bazë të nenit 272, par. 1 dhe 2 të KPK-së. Kolegji nuk gjen prova të mjaftueshme për të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se individët e lartpërmendur kanë kryer këtë veprë penale. Për këtë arsye, ata lirohen nga vepra në fjalë.
102. Sa i përket bashkimit të veprave penale, neni 80 i KPRK-së përcakton që: *"Nëse kryerësi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik."*
103. Kolegji vëren se për të ekzistuar bashkimi i veprave penale, duhet të plotësohen dy kushte: kushti i parë është që i njëjti person të marrë pjesë në kryerjen e disa veprave penale, ndërsa i dyti që kryerësi të gjykohet për të gjitha veprat penale të kryera në të njëjtën kohë.
104. E pandehura **N.V.** i ka ndryshuar të dhënat e llogarisë bankare në faturat e OeSD-së duke i zëvendësuar të dhënat e veta bankare me ato të OeSD-së duke mashtruar kështu përmes përdorimit të autorizimit në fjalë dhe duke shtyrë MPB-në që t'i paguajë paratë e faturave në llogarinë e saj bankare. Është e qartë se në mes të datave 13 dhjetor 2011 dhe 3 gusht 2012, gjithsej shtatë transfere parash janë bërë nga MPB-ja në llogarinë bankare të Consulting EU në bankën NLB. Shuma të ndryshme parash pastaj ishin transferuar në llogari të ndryshme bankare.
105. Për këtë arsye, kolegji e vëren se, në rastin në fjalë, kriteret për ekzistimin e bashkimit të veprave penale

janë plotësuar në tërësi sa i përket të pandehurës **N.V..**

Vendimi mbi dënimin

106. Duke i pasur parasysh rrethanat e rastit në fjalë, mënyrën si është kryer krimi - *modus operandi* si dhe intensitetin e rrezikut shoqëror nga vepra penale, gjykata vjen në përfundim se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, d.m.th. është në përputhje me qëllimin e dënimit, siç përcaktohet me ligj. Prandaj, Gjykata e Apelit me respekt pajtohet me gjykatën e shkallës së parë se kjo lëndë është shumë e rëndë dhe si e tillë kërkon dënimin e rëndë. Megjithatë, edhe pse nuk kemi obligim ta ulim dënimin për shkak të ndryshimit të pjesëshëm, kolegji e konsideron të udhës, duke u mbështetur në parimin e proporcionalitetit, që ta ulë dënimin ndaj të pandehurve. Duke marrë parasysh se përfshirja e të pandehurve në kryerjen e këtyre krimeve nuk është e njëjtë për nga intensiteti pasi që jo të gjithë ata kanë pranuar shuma të njëjta të parave, është e udhës dhe në interes të zbatimit të duhur të drejtësisë të përshtaten dënimet individualisht kundër çdonjërit prej tyre. Prandaj dënimet kundër të pandehurve ulen.

URDHRI PËR KONFISKIM

107. Kolegji e vëren se sendet e përdorura ose ato që janë planifikuar të përdoren në kryerjen e veprës penale, apo gjësendet që kanë ardhur si pasojë e kryerjes së veprës penale, duhet patjetër të konfiskohen.

108. Kolegji është i bindur se në rastin në fjalë, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar drejt se banesa e të pandehurës **N.V.**, në rrugën Tirana, nr. 42, në Prishtinë, është blerë me paratë të cilat ajo i ka fituar në mënyrë të kundërligjshme nga MPB-ja dhe të cilat ajo nuk i ka transferuar në OeSD.

109. Është vërtetuar drejt se banesa B/1, në katin e tetë, me sipërfaqe prej 66.2 m², në ndërtesën A1, banesa

2B+p+8+NK, në bllokun A11, zona Mati 1, në Prishtinë, Kosovë, në vlerë prej përafërsisht 45,000 eurosh, është blerë nga **E.D.**, me paratë e fituara nga krimi.

110.Kolegji, megjithatë, konstaton se urdhri konfiskues në pikën I.b nuk i identifikon si duhet asetet e restorantit që ndodhet në pjesën perëndimore të stadiumit të qytetit në Prishtinë, Kosovë, në sipërfaqe prej 586 m², në vlerë prej përafërsisht 250,000 eurosh, të cilat pretendohet se janë blerë nga **E.D.**.

111.Kolegji, prandaj, e konfirmon urdhrin konfiskues, të identifikuar me shifrën PKR nr. 1046/14, të nxjerrë nga Gjykata Themelore e Prishtinës, i datës 18 dhjetor 2014, në pikat I.a dhe I.c.

112.Urdhri konfiskues i përmendur më lart, ndryshohet në pikën I.b, ngase kërkesa për konfiskimin e asetëve të përmendura me emër në pikën I.b, nuk i identifikon në mënyrë të mjaftueshme asetet në fjalë.

V. KONKLuzionet e Gjykatës së Apelit:

Për arsyet e përmendura më lart, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit në Prishtinë

PAKR 216/15, më 9 dhjetor 2015

Kryetari i kolegjit:

Procesmbajtësit

Dariusz Sielicki

Adam Viplak

Gjyqtar i EULEX-it

Zyrtar ligjor i EULEX-it

Adnan Isufi

Këshilltar ligjor i
EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Elka Filcheva-Ermenkova

Gjyqtare e EULEX-it

Xhevdet Abazi

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit